

Jeni dhe je bërë objekt i dhunës në një lidhje të afërt familjane

Dhuna në një lidhje të afërt do të thotë shumë gjëra. Ndonjëherë është një prind që e bën objekt dhune një fëmijë. Ndonjëherë është vëllai/motra. Por, mund të jetë edhe dikush tjetër nga farefisi. Ndoshta është dikush me të cilin/cilën ke një lidhje. Dhuna mund të jetë si dhunë psikike, fizike dhe seksuale. Mund të bëhet fjalë që dikush:

- Të quan ty të keq/keqe dhe të ligë ose ti mund të dëgjosh se ti je i keq/e keqe dhe e bezdisshme
- Të shtynë, të godet, të shqelmon ose të lëndon në ndonjë mënyrë tjetër
- Të kontrollon dhe të kufizon, të detyron të bësh gjëra që ti nuk dëshiron t'i bësh
- Të kërcënon të të përzë nga shtëpia ose të mbyllë brenda në shtëpi
- Të detyron të bësh diçka seksualisht
- Të detyron të ndjekësh disa rregulla për të mbrojtur famën e familjes
- Përdor dhunë ndaj dikujt tjetër në familje

Ti ke të drejtë të kesh mbrojtje dhe mbështetje

Është e zakonshme që shqetësohesh dhe mërzitesh kur je bërë objekt i dhunës. Është me rëndësi të bisedosh për këtë gjë me dikë që të dëgjon dhe dëshiron të të ndihmoj. Nëse dikush nën moshën 18 vjeç është bërë objekt i dhunës, në atë rast është gjithmonë përgjegjësi e të rriturve. Te Shërbimi social mund të kesh ndihmë e mbështetje, mbrojtje, por edhe rreth gjërave praktike.

Ti mund të kesh ndihmë me:

- Biseda mbështetëse
- Mbrojtje dhe banim të përkohshëm
- Biseda mbështetëse me familjen tënde për të pasur ndihmë të trajtosh konfliktet

Na kontakto ne që të ndihmojmë ty. Ti mund të jesh anonim dhe ti nuk ke nevojë të tregosh si qhesh ti ose ku banon.

Në rast të rrezikut akut, telefono gjithmonë 112.

Kontakto:

- **Vepimtarinë:** Barn och ungdomsenhetens mottagningsgrupp
- **Numri i telefonit:** 08-58169000
- **Uebfaqja:** www.upplands-bro.se
- **Adresa e selisë/vizitës:** Furuhällsplan 1, Kungsängen

Fëmijët që përjetojnë dhunë në një lidhje të afërt

Të përjetosh dhunë do të thotë që:

- Të bëhesh objekt i dhunës (që nga goditjet, shtyrjet, dhunës seksuale, shqetësimeve dhe kërcënim për distancim emocional)
- Të shohësh ose të dëgjosh dhunë
- Të shohësh shenjat e dhunës (p.sh. i/e mavijosur, gjëra të thyera, frikë)
- Të ndjesh atmosferën në shtëpi

Shumica e fëmijëve janë të vetëdijshëm se çfarë ndodhë në familje, edhe pse të afërmit nuk e besojnë këtë gjë. Fëmijët e kuptojnë shpejtë nëse dikush i afërm nuk ndjehet mirë, por ata nuk tregojnë për ndjenjat e tyre. Që një fëmijë ndjehet keq ose ndjenë shqetësim, kjo mund të shfaqet në lojë ose në ndonjë mënyrë tjetër se si ata sillen.

Bë një lajmërim për shqetësimin

A dyshon ti se fëmija juaj pëson keq? Bë një lajmërim për shqetësimin në Shërbimin social. Shërbimi social bën një shqyrtim të gjendjes, jep ndihmë përmes bisedave mbështetëse dhe ndërmer masat e nevojshme.

Disa nëpunës të profesioneve të ndryshme, sipas ligjit e kanë për detyrë të bëjnë një lajmërim për shqetësimin. Kjo vlen për ty që punon p.sh. në shkollë, në kujdesin mjekësor ose në polici.

Mbështetje dhe ndihmë për fëmijët të cilët kanë përjetuar dhunë

Nga Shërbimi social munden fëmijët dhe të afërmit e tyre të kenë ndihmë. P.sh:

- Biseda mbështetëse
- Veprimtari në grup për fëmijë
- Mbështetje në rolin e tyre si prindër për të mirën e fëmijëve
- Person kontaktues ose familje kontaktuese
- Masa të tjera nëse situata bëhet akute, p.sh. shtëpi kujdestare.

Në rast të rrezikut akut, telefono gjithmonë 112.

Kontakto:

- **Veprimtari në:** Barn och ungdomsenhetens mottagningsgrupp
- **Numri i telefonit:** 08-58169000
- **Uebfaqja:** www.upplands-bro.se
- **Adresa e selisë/vizitës:** Furuhällsplan 1, Kungsängen